

ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM TË PROVIMIT TË MATURËS NË GJIMNAZ, GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, JANAR 2016

DETYRA 1. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Projekti “Ura e konsumit evropian”*; pranohet edhe përgjigjja pa thonjëza

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 2. – 1 pikë

2. T'u tërheqin vërejtjen klientëve për dëmin që mund t'u ndodhë nëse nuk janë sa duhet të informuar

DETYRA 3. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar saktë të tri mënyrat në të cilat konsumatorët mund t'i fitojnë informacionet:

Numri i telefonit: +382 20 244170;

E-maili: cezap@t-com.me

www.cezap.org

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 4. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar saktë dy ose tri përgjigje:

formale - mbiemër

domosdoshmërisht – ndajfolje

nuk – pjesëz

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 5. – 1 pikë

2. Të tregojë shkurt përmbajtjen e shfaqjes

DETYRA 6. –Nxënësi/ja merr gjithsej 3 pikë nëse ka rrethuar saktë dhe dhënë shpjegime të sakta si më poshtë:

| KONSTATIMI | Saktë Pasaktë | SHPJEGIMI PËRGJIGJES |
|---|--------------------|---|
| Tema është e njëjtë në të dy tekstet | Nëse ka rrethuar S | <i>Po sepse flitet për komedinë “Burri burrë”</i> |
| Tekstet i takojnë të njëjtit lloj. | Nëse ka rrethuar P | <i>Teksti nën 1 është njoftim, kurse i dyti tregon shkurt për përmbajtjen e shfaqjes</i> |
| Për vënien në skenë të kësaj shfaqjeje meritat i takojnë QIK “Malësia” në Tuz | Nëse ka rrethuar P | <i>Jo sepse shfaqja vetëm shfaqet në QKI “Malësia”, kurse vënien në skenë e bën Teatri i Qytetit të Vushtrrisë.</i> |

Për çdo rrethim të saktë dhe dhënie të shpjegimit të saktë nga 1 pikë
Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 7. – 1 pikë

2. Të tashmen

DETYRA 8. – 1 pikë

3. reportazhit

DETYRA 9. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: Teksti është shkruar në stilin publicistik/në stilin gazetaresk

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 10. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: Në qytezën Roses/Në qytezën Roses në bregun e Kosta Bravës në Spanjë (Vërejtje: Nxënësi/ja në përgjigjen e vet duhet të përmend qytezën Roses)

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 11. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: Në formën e kubeve të borës, fletëve të holla, në formë të vezëve në të cilat në vend të kuqit të vesë ndodhet kremi me shije të karameles (dhe përgjigje të ngjashme të sakta)

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 12. – 1 pikë

1. Për pesëdhjetë mysafirë

DETYRA 13. – 1 pikë

1. një vit përpara

DETYRA 14. –Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka përshkruar fjalinë nga teksti: “Pronarët thonë se gatimi është një gjuhë me të cilën kreativiteti, harmonia, gëzimi, bukuria, poezia, magjia, humori dhe kultura shprehen më së miri” ose e perifrazon.

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 15. – Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Folja shkruanim është në kohën e pakryer/në të pakryerën*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 16. – Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Periudha e dhënë është në marrëdhënie bashkërenditëse kundërshtore/kundërshtore. Shpjegimi fjalia e dytë e periudhës kundërshton të parën.*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 17.- Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Përcaktor kallëzuesor*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 18. – Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar:

1. *Kallëzore*
2. *Gjinore*
3. *Emërore*
4. *Dhanore*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 19. – Nxënësi/ja merr gjithsej 2 pikë

A) 1 pikë nëse ka përdorur në rasën e duhur fjalën nga kllapat: *Ariani shpeshherë prej pullazit e shikonte ndeshjen e futbollit.*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

B) 1 pikë rrjedhorja.

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 20. – Nxënësi/ja merr gjithsej 2 pikë

A) 1 pikë nëse ka rrethuar përgjigjen nën 2. Apofoni.

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse ka rrethuar ndonjë përgjigje tjetër, ka rrethuar përgjigjen e saktë dhe të pasaktë, nuk ka rrethuar asgjë.

B) 1 pikë nëse ka shpjeguar ndryshimin fonetik të Apofonisë i cili është alternimi apo kalimi i zanores e në o te folja brodha e që ngjan kryesisht në kohën e kryer të thjeshtë.

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 21. – Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Forma poetike në të cilën është shkruar poezia e dhënë quhet sonet/Sonet*

Vërejtje: Pranohen edhe përgjigje të ngjashme të sakta

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 22. – 1 pikë

1. Erotik

DETYRA 23. – Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka gjetur simbolin-*pranga* dhe ka treguar se aj paraqet robërimin e poetit

Vërejtje: *Pranohet si përgjigje e saktë edhe nëse nxënësi/nxënësja e ka nënvizuar vargun e kërkuar*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë/nuk ka nënvizuar vargun e kërkuar ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 24. – 1 pikë

3. mëshirë për vuajtjet e veta

DETYRA 25. – Nxënësi/ja merr gjithsej 2 pikë

A) 1 pikë nëse ka shkruar se: *Në kuptimin figurativ, vargu shpreh robërimin e poetit nga dashuria; ky sheh gjithkund të dashurën e vet, edhe pse kjo s'është askund.*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

B) 1 pikë nëse ka përshkruar vargun: *Shikoj pa sy, gjuhë nuk kam e bërtas,*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 26. – Nxënësi/ja merr gjithsej 2 pikë

A) 1 pikë nëse ka rrethuar përgjigjen nën 1. Antitezën.

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse ka rrethuar ndonjë përgjigje tjetër, ka rrethuar përgjigjen e saktë dhe të pasaktë, nuk ka rrethuar asgjë.

B) 1 pikë nëse ka shpjeguar përdorimin e Antitezës në vargun e dhënë: *Nëpërmjet antitezës paqe dhe luftë poeti nxjerr në pah gjendjen e mundimshme shpirtërore në të cilën ndodhet ai që dashuron pa përgjigje etj.*

Nxënësi/ja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 27. – 1 pikë

1. Dramës

DETYRA 28. – Nxënësi/ja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Hakmarrjen***Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar**DETYRA 29. – 1 pikë**

3. veten e tij

DETYRA 30. – Skema për vlerësimin e esesë**1. MIHAL GRAMENO “OXHAKU”****Përmbajtja 15 pikë**

| | |
|----------------------|---|
| Kërkesa 1. | Nxënësi/ ja tregon: 1. për periudhën letrare që i takon Mihal Grameno (Romantizmit) (1 pikë) 2. për formën letrare që i përket vepra (novelë) (1 pikë) 3. për simbolikën e emërtimit të veprës (1 pikë) Gjithsej 3 pikë |
| Kërkesa 2. | Nxënësi/ ja: 1. shkruan për ngjarjen që zhvillohet në vepër (rrëfen një histori dashurie që pengohet nga paragjykimet e mjedisit, por që është aq e fortë sa fiton mbi gjithçka) (1 pikë); nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil (2 pikë) Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 3. | Nxënësi/ ja: 1. shkruan për rrethanat që bënë që vepra të marrë një kahe negative (1 pikë) 2. thekson intrigat që u bënë në vepër (1 pikë); 3. shkruan për shkaktarin kryesor të të gjitha vështirësive dhe komplikimeve në vepër (1 pikë) nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil (2 pikë) 4. shkruan për ndryshimin në jetën e personazheve në vepër (1 pikë) 5. shkruan për njohjen e Vahidesë me Rushan beun (1 pikë) Gjithsej 6 pikë |

| | | |
|-----------------------------|---|------------------------|
| Kërkesa 4. | Nxënësi/ ja: 1. shkruan qartë për gërshetimin e ngjarjeve që sjellin deri tek fundi i lumtur (1 pikë); nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil. (2 pikë) | Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 5. | Nxënësi/ ja: 1. jep një mendim të saktë se cila është porosia e veprës (1 pikë); nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil. (2 pikë) | Gjithsej 2 pikë |

Gjuha dhe forma e tekstit 10 pikë

| Leksiku | Saktësia gjuhësore | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|--|--|--|---|
| → origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale | → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi , përemrit i vet/ i tij , përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar | → lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve 2 pikë | → përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët) 2 pikë |

| | | | |
|---|---|--|---|
| | <p>në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p style="text-align: center;">2 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p style="text-align: center;">2 pikë</p> <p style="text-align: center;">Gjithsej 4 pikë</p> | | |
| <p>→ përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia,</p> | <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla</p> | <p>→ lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të</p> | <p>→ ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan</p> |

| | | | |
|---|---|---|--|
| <p>përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p> | <p>(p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p> | <p>përkohshme në nivel të paragrafëve</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p> | <p>paragrafët brenda shtjellimit</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p> |
|---|---|---|--|

2. ZANATI (NUK) ËSHTË ME VLERË ARI

Përmbajtja – 15 pikë

| | |
|--|---|
| <p>Kërkesa</p> <p style="text-align: center;">1.</p> | <p>Nxënësi/ja numëron:</p> <p>- llojet e ndryshme të punës dhe zanateve (1 pikë)</p> <p>Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë)</p> |
|--|---|

| | | |
|-------------------|---|------------------------|
| | | Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 2. | Nxënësi/ja sqaron: - sa është me rëndësi të zgjidhet puna që e duam (1 pikë) Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë) | Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 3. | Nxënësi/ja: - përshkruan një zanat që mendon se kërkon njohuri dhe aftësi (1 pikë) - sqaron domosdoshmërinë e kreativitetit për atë zanat (1 pikë) Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë) | Gjithsej 3 pikë |
| Kërkesa 4. | Nxënësi/ja: - argumenton nëse do të (ose nuk do të) donte që të merrej me ndonjë zanat (1 pikë); Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë) | Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 5. | Nxënësi/ja jep qëndrimin e vet për temën (1 pikë) Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë) | Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 6. | Nxënësi/ja jep argumente (1 pikë) Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë) | Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 7. | Nxënësi/ja jep ndonjë shembull (1 pikë) Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil (1 pikë) | Gjithsej 2 pikë |

Gjuha dhe forma e tekstit 10 pikë

| Leksiku | Saktësia gjuhësore | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|--|---|--|--|
| → origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, | → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi | → lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve 2 pikë | → përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; |

| | | | |
|---|---|--|---|
| <p>figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale</p> <p style="text-align: center;">2 pikë</p> | <p>semantik i parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p style="text-align: center;">2 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk</p> | | <p>brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p style="text-align: center;">2 pikë</p> |
|---|---|--|---|

| | | | |
|---|---|--|--|
| | <p>shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> | | |
| <p>→ përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta</p> <p>1 pikë</p> | <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p> | <p>→ lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve</p> <p>1 pikë</p> | <p>→ ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p>1 pikë</p> |

